


Nr. i Prokurimit: 212 19 843 236 & 212 19 002 236 – Titulli: “Sigurimi i veturave zyrtare të MAPL-së TPL, TPL+ dhe KASKO e Plotë”



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
MINISTARSTVO ADMINISTRACIJE LOKALNE SAMOUPRAVE
MINISTRY OF LOCAL GOVERNMENT ADMINISTRATION

KUSHTET E VEÇANTA DHE ANEKSET E NDËRLIDHURA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ("Autoriteti Kontraktues"),

dhe

Kompania e Sigurimeve " SCARDIAN " J.S.C., Prishtinë

janë pajtuar si në vijim:

TITULLI I KONTRATËS:

“Sigurimi i veturave zyrtare të MAPL-së TPL, TPL+ dhe KASKO e Plotë”

Numri i identifikimit: 212 19 843 236

Numri i brendshëm: 212 19 002 236

Numri rendor i kontratës: 02/2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal,

01 Prill 2019

Nr. i Prokurimit: 212 19 843 236 & 212 19 002 236 – Titulli: “Sigurimi i veturave zyrtare të MAPL-së TPL, TPL+ dhe KASKO e Plotë”

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: “Sigurimi i veturave zyrtare të MAPL-së TPL, TPL+ dhe KASKO e Plotë”

Nr. i Artikullit.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi njësi Pa TVSH - €	TVSH (%)	ÇMIMI NJËSI ME TVSH €	Çmimi total me TVSH €	Koha e dërgesës
A	A) Sigurimi i automjeteve ndaj palëve të treta (TPL)							
1.	VW Passat 3C	Copë	1	130.00	23.40	153.40	153.40	12 orë
2.	Peugeot 407 2.0 HDI	Copë	1	156.00	28.08	184.08	184.08	12 orë
3.	Hunday accent crdil.6	Copë	2	105.00	18.90	123.90	247.80	12 orë
4	Citroen C-ELYSEE 1.6 HDI 90	Copë	1	105.00	18.90	123.90	123.90	12 orë
TOTALI PËR PAGES (Pjesa A):							709.18 €	
B	B) Sigurimi i automjeteve - Tpl +(plus) (Sigurimi i automjeteve për shtetet e regjionit)							
1.	VW Passat 3C	Copë	1	39.00	7.02	46.02	46.02	12 orë
2.	Peugeot 407 2.0 HDI	Copë	1	46.80	8.42	55.22	55.22	12 orë
3.	Hunday accent crdil.6	Copë	2	31.50	5.67	37.17	74.34	12 orë
4.	Citroen C-ELYSEE 1.6 HDI 90	Copë	1	31.50	5.67	37.17	37.17	12 orë
TOTALI PER PAGES (Pjesa B):							212.75 €	
C	C) Sigurimi i automjeteve KASKO e plotë							
1.	VW Passat 3C	Copë	1	29.00	5.22	34.22	34.22	12 orë
2.	Peugeot 407 2.0 HDI	Copë	1	27.00	4.86	31.86	31.86	12 orë
3.	Hunday accent crdil.6	Copë	2	29.00	5.22	34.22	68.44	12 orë
4	Citroen C-ELYSEE 1.6 HDI 90	Copë	1	39.00	7.02	46.02	46.02	12 orë
TOTALI PER PAGES (Pjesa C):							180.54 €	
TOTALI I PËRGJITHSHËM (A+B+C):							1,102.47 €	

1.2 Kontrata hynë në fuqi me datën: 01.04.2019 dhe përfundon me datën: 31.03.2020. Shërbimet do të fillojnë menjëherë, sipas kërkesave të MAPL-së. Kontrata do të jetë valide 1 vit pas nënshkrimit.

Nr. i Prokurimit: 212 19 843 236 & 212 19 002 236 – Titulli: “Sigurimi i veturave zyrtare të MAPL-së TPL, TPL+ dhe KASKO e Plotë”

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se *[shëno numrin]* ditë nga data e marrjes së urdhërës.

1.4 Vendi i *[dërgimit të furnizimeve]* *[ekzekutimit të punëve]* *[kryerjes së shërbimeve]* do të jetë *[shëno vendin]* Në lokacionin e Operatorit ekonomik fitues të kontratës.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **1,102.47 €; Njëmijë e njëqind e dy euro e dyzet e shtatë cent.**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[nëse kontrata përbëhet vetëm nga një dërgesë shëno]

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës]

[nëse kontrata përbëhet nga më shumë se një dërgesë shëno]

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

¹ DDP Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Nr. i Prokurimit: 212 19 843 236 & 212 19 002 236 – Titulli: “Sigurimi i veturave zyrtare të MAPL-së TPL, TPL+ dhe KASKO e Plotë”

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i ~~[furnizimeve]~~ ~~[shërbimeve]~~ ~~[punëve]~~ duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të ~~[furnizimeve]~~ ~~[shërbimeve]~~ ~~[punëve]~~.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin ~~[t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat]~~ ~~[të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet]~~ ~~[të kryejë ndonjë ose të gjitha punët]~~ brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së ~~[furnizimeve]~~ ~~[punëve]~~ ~~[shërbimeve]~~ të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res-judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

Nr. i Prokurimit: 212 19 843 236 & 212 19 002 236 – Titulli: “Sigurimi i veturave zyrtare të MAPL-së TPL, TPL+ dhe KASKO e Plotë”

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [Gjykatën Ekonomike në Prishtinë] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

Adresa e Autoritetit Kontraktues:

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal,

Numri fiskal: 600328331

Ndërtesa e ish "Rilindjes", kati i 12, Salla nr.1220, Divizioni i Prokurimit MAPL, Prishtinë

Personi përgjegjës i prokurimit i Autoritetit Kontraktues

Emri dhe Mbiemri: **Lumnije Azemi**

Titulli: **U.D Udhëheqëse e Divizionit të Prokurimit**

Nr. i Tel: + 381 (038) 200 35 603

E-maili: **lumnije.azemi@rks-gov.net**

Menaxher i prokëtit nga MAPL-ja:

Emri dhe Mbiemri: **Hashim Berisha**

Titulli: **Vozitës**

Nr. i telefonit: 038/ 200 35 650

E-mail: **hashim.berisha@rks-gov.net**

Adresa e Kontraktuesit:

Kompania e Sigurimeve "SCARDIAN" J.S.C, Prishtinë

Numri i Biznesit: 71055124

Nr. i llogarisë bankare: XK05 1117008602000181 Procredit Banka

Menaxheri i projektit nga Operatori Ekonomik

Emri dhe Mbiemri: **Leonora Demaj**

Titulli: **Menaxhere**

Nr. i telefonit: **038/ 777 – 444 & +383 49 909 089**


E-mail: **valon.gjiko@scardian.com & leonora.demaj@scardian.com**

Nr. i Prokurimit: 212 19 843 236 & 212 19 002 236 – Titulli: ““Sigurimi i veturave zyrtare të MAPL-së TPL, TPL+ dhe KASKO e Plotë”

E hartuar në gjuhën [Shqipe]² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	VALON GJIKOLLI	Emri:	Lumnije Azemi
Pozita:	ZYRTAR I MARRJES MË SIGURIM	Pozita:	U.D Udhëheqëse e Divizionit të Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	01.04.2019	Data:	01.04.2019
Vula:		Vula:	



² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.